



BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK
GRUPI I KËSHILLTARËVE TË PARTISË DEMOKRATIKE

222777net

Tiranëmë, 23.12.2015

Drejtuar: **Z. Erion Veliaj**
Kryetar
BASHKIA TIRANË

Për dijëni: **Z. Aldrin Dalipi**
Kryetar
Këshilli Bashkiak

Lënda: Kërkesë për dhënie informacioni

I nderuar Z. Kryetar,

Në mbështetje të nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenit 11, pika 4 të Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak, nenit 14, pika 1, shkronja “c”i “Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës”, në cilësinë dhe në ushtrim të funksionit të Kryetarit të Grupit të Këshilltarëve të Partisë Demokratike, kërkoj të pajisem me informacionin e detajuar si dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje me sa më poshtë:

1. Numri i të punësuarve (me status të nëpunësit civil/kontratë pune) prane Bashkisë Tiranë dhe institucioneve në varësi të saj, me te cilët Bashkia Tiranë/institucionet në varësi të saj kanë ndërprerë në mënyrë të njëanshme marrëdhënien e punës nga data 23.07.2015 e deri ditën e marrjes së kësaj kërkesë (*dokumentacioni dhe akti administrativ përkatës*);
2. Shkaku ligjor për ndërprerjen në mënyrë të njëanshme të marrëdhënies së punës për secilin person të larguar (*dokumentacioni dhe akti administrativ përkatës*);
3. Mënyra e njoftimit (verbal/me shkresë/e-mail/etj.) e ndjekur për bërjen me dije të shuarjes/ndryshimit të marrëdhënies së punës (*dokumentacioni që provon kryerjen e njoftimit*);
4. Numri i të punësuarve rishtazi dhe procedura ligjore e ndjekur për çdo punësim të kryer (*dokumentacioni dhe akti administrativ përkatës*);
5. Ndryshimet në strukturën dhe organikën e Aparatit të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë, pasojat që ka sjellë (në numër) ristrukturimi i sa më sipër nga data 23.07.2015 deri në ditën e marrjes së kësaj kërkesë (*dokumentacioni dhe aktet administrative përkatëse*).

Informacionin e kërkuar më sipër, në pikat 1, 2 dhe 3, Ju lutem pasqyrojeni edhe në tabelën bashkëlidhur kësaj shkrese.

Duke e vlerësuar si thelbësore për respektimin e standardeve të shtetit të së drejtës, jo vetëm garantimin e parimit të ligjshmërisë, por edhe qeverisjen transparente, mbetemi në pritje të informacionit dhe dokumentacionit përkatës, brenda afatit ligjor.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

LEONARD OLLI

KRYETAR

GRUPI KËSHILLTAREVE TË PARTISE DEMOKRATIKE

